



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 12.2 shkronja d), 40.2 shkronja c) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, nenit 2.3, dhe nenit 4 të Ligjit për financat e pushtetit lokal nr.03/L-049, Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë nr.03/L-048, nenit 16 paragrafi 9 të Ligjit nr.07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, nenit 34 paragrafi 2.3 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 04 qershor 2021, miratoi këtë;

VENDIM

PËR TRANSFERIMIN E MJETEVE BUXHETORE NGA KATEGORIA REZERVË- 38 NË KATEGORINË E SHPENZIMEVE INVESTIME KAPITALE (burimi i financimit 10)

Neni 1

Mjetet buxhetore nga kategoria rezervë-38, burimi i financimit 10, në kuadër të buxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2021, në shumë totale 380,930.00€, nga nën-programet:

- Bujqësia (47005), në vlerë.....	100,000 €
- Planifikimi Hapësinor dhe Rregullativ (66030), në vlerë.....	80,000 €
- Administrata e Shëndetësisë (73014), në vlerë.....	100,000 €
- Shërbimet e Shëndetësisë Primare (73300), në vlerë.....	100,930 €
Shuma totale.....	380,930 €

Transferohen në kategorinë e shpenzimeve Investime Kapitale, në nën-programet si vijon:

- **Planifikim Hapësinor dhe Rregullativ (66030)**, kodi (projekt i ri) - Ndërtimi i hapësirave të reja publike në qytet, shuma..... **80,000 €**
- **Shërbimet e shëndetësisë primare (73300)**, kodi (projekt i ri) - Ndërtimi i objektit të QMF 3 - në Podujevë, shuma..... **100,930 €**
- **Administrata e Shëndetësisë (73014)**, kodi (projekt i ri) - Ndërtimi i shtëpive për rastet sociale, shuma..... **100,000 €**
- **Arsimin Para fillor dhe Çerdhe (92290)**, kodi - (projekt i ri) - Ndërtimi i objektit të Çerdhes në qytet afër shkollës "Fan S. Noli", shuma **100,000 €**

Neni 2

1. Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet Vendimi nr.prot.01-400/03-0035827/21 i Kuvendit të komunës i miratuar më 29 prill 2021

Nr.01-400/03-0045239/21
Podujevë, 04 qershor 2021



Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi